



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
PREFEKTI I QARKUT VLORE
SEKTORI JURIDIK

Nr. 1884 prot.

Vlorë, më 09. 09. 2017

Lënda: Shprehje për ligjshmërinë e vendimeve të Këshillit të Bashkisë Himarë.

KRYETARIT TË BASHKISË HIMARË

Për dijëni: Këshillit të Bashkisë Himarë.

Në mbështetje dhe zbatim të neneve 8 dhe 16 të Ligjit nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", shprehemi si më poshtë:

1. Vendimi i Këshillit të Bashkisë Himarë nr. 121, datë 30.08.2017 "Për dhënien e ndihmës ekonomike për periudhën 01-31 Gusht 2017".

Bazuar në nenin 6/1 dhe nenin 11/2, të Ligjit nr.44/2016 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr.9355", si dhe V.K.M nr.955, datë 07.12.2016 "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmave ekonomike", ndihmat ekonomike shpërndahen 1 herë në muaj, me vendim të strukturave rajonale të Shërbimit Social Shtetëror.

Institucioni i Prefektit nuk mund të shprehet mbi ligjshmërinë e vendimit, pasi duhet t'i referoheni ndryshimeve të ligjit.

2. Vendimi i Këshillit të Bashkisë Himarë nr. 122, datë 30.08.2017 "Mbi miratimin e përgatitjes së materialit të Planit të Përgjithsëm Vendor të Bashkisë Himarë", vlerësohet i ligjshëm si procedurë.

